



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5340 /2020
Data: 17.08.2020

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e shtatë -VII- për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 07.07.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2020.
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm i Komunës së Hanit të Elezit.
4. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga komuna e Hanit të Elezit.
5. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2021.
6. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për gjashtë mujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2020.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- te rendi i punës duhet të jetë shqyrtimi i kornizës ,po ashtu i njëjti gabim është edhe te pika e rendit të ditë dhe duhet të jetë shqyrtimi i kornizës .te diskutimi imë në vend të fjalës gandi të jetë fjala granti.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Qershor 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- shpenzimi për periudhën janar-qershor 2020, për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve është në shumë prej 1,068,185.70 € apo 36.34% e planit të përgjithshëm vjetor. Pagesat nga kategoria ekonomike pagat dhe mëditjet janë 768,907.83 € ose 50.02% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 pagesat për këtë kategori kemi rritje për 4.98% apo 36,490.12 €.

Pagesat për këtë kategori ekonomike mallra dhe shërbime për 6 mujorin e parë 2020 janë 126,562.94 € apo 38.45% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi një shpenzim më të madh për 22,868.48 €. Pagesat për shpenzime komunale gjashtëmujorin e parë 2020 janë në shumë prej 22,500.10€ apo 37.50% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi rritje për 899.87 € apo 4.17%. Pagesat nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere për gjashtëmujorin e parë 2020 janë në shumë prej 34,300.00 € apo 42.22% e planit vjetor. Ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi një shpenzim më të vogël për 16,033.80 €. Pagesat nga kategoria ekonomike shpenzimet kapitale janë në shumë prej 115,914.83 € apo 15.20% e planit vjetor. Të hyrat vetanake për këtë periudhë gjashtëmujore 2020 janë realizuar në shumë prej 127,951,20 € apo për 41,986.88 € më pak se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Mehmet Ballazhi thekson:- në raport shihet një ngritje e shpenzimeve të pagat dhe mëditjet, kërkoj sqarim sa i përket kësaj ngritje. Pagesa për 30 bursistët është bërë në shumë prej 14 500 € kërkoj sqarim.

Shabi Rexhallari thekson:- te kategoria për pagat dhe mëditjet është një ngritje në shumë prej 36,490.12 € për shkak se mjekët dhe infermierët kanë përfituar nga 300 € për dy muaj, zjarrfikësit dhe inspektorët. Krahas këtyre shpenzimeve kemi pasur paga edhe pas pensionimit dhe shpërblimet jubilarë të cilat ishin në arsim. Në kuadër të kësaj kemi edhe dy punëtorë të projekti i IPA fonde me që për një muaj shpenzime i kanë 1500 €. Vendimi është marr për 15 000 € dhe nga 30 studentët të cilët ishin përfitues dy prej tyre nuk kanë mundur me marr bursën e plotë në shumë 500 € por nga 375 € sepse ishin studentë prej një familje.

Kryesuesi thekson:- për ligjin e pagave ju kanë ndarë mjete financiare edhe komunave dhe ato mjete a do të kthehen në nivel qendrorë apo do ti menaxhon komuna.

Shabi Rexhallari thekson:- kur është miratuar buxheti një pjesë të mjeteve financiare i kanë dërguar në kategorinë rezervë të buxhetit dhe kjo shumë për komunën tonë është 168 787.00 €. Në muajin tjetër do të bëjmë kërkesë për transfer të mjeteve financiare që nga kategoria rezervë me u bartur në investime kapitale.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U VOTUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm i Komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- kemi parashtruar kërkesë në departamentin e ministrisë së financave për me bërë auditimin dhe ministria e ka planifikuar në planin e tyre për me bërë auditimin dhe auditimi është bërë. Raportin e keni të auditimit dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- auditori nuk ka paraqitur ndonjë shkelje por mungesën e informacioneve sidomos te projektet . Cilat janë tri rekomandimet e vitit 2017 të cilat nuk janë zbatuar.

Shabi Rexhallari thekson:- te plani i veprimit janë për secilin rekomandim edhe datën e planifikuar se kur përfundon rekomandimi sipas menaxhmentit të komunës dhe cilët janë personat përgjegjës për zbatimin rekomandimit. Raportet të cilat do ti paraqesim te Ministria dhe te zyra kombëtare e auditimit do t'i paraqesim në kuvend se deri ku kemi arritur me rekomandimet.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U VOTUA RAPORTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga komuna e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U VOTUA PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMNDIMEVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NGA KOMUNA E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- sipas praktikave të më hershme propozoj që KPF me qenë në grupin punues . Në fillim do t'i diskutojmë pikat me ekzekutivin e komunës dhe pastaj do tua përcjell grupit punues dhe në muajin shtatorë e përcjellim për miratim në kuvendin e komunës. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nora Xhoni thekson:- është mirë me u përfshirë të gjitha partitë politike në grupin punues.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA THEMELIMI I GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për gjashtë mujorin e N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- sipas informatave që kam afër 894 kontinierë janë ardhur, mirëpo sa familje janë që paguajnë dhe si do të bëhet shpërndarja e kontinierëve. Është vërejtje edhe prej qytetarëve që gjatë zbrazjes së kontinierëve punëtorët nga pakujdesia i kanë dëmtuar kontinierët. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kujtim Dernjani thekson:- janë 1247 ekonomi familjare të cilët kanë kontrata. Ka pasur raste kur qytetarët janë ankuar për shkak dëmtimit të kontinierëve nga ana e punëtorëve por kompania ua ka blerë kontinierët . I kam propozuar kryeshefit që nëse punëtorët i dëmtojnë kontinierët nga pakujdesia me ua hequr mëditjen. Sipas gjendjes në teren besoj që me këtë numër të kontinierëve do të mbulohet tërë territori.

Mehmet Ballazhi thekson:- është mirë që punëtorët me dal në teren dhe me i pa nevojat se kush ka nevojë për me u pajisur me kontinierë . Është mirë që punëtorët me pasur kujdes gjatë zbrazjes së kontinierëve dhe me i lënë aty ku i marrin. Është mirë që me bërë një flet palosje për çështje të informimit dhe sensibilizimin e opinionit të qytetarëve për vetëdisim për çështje të mbeturinave.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI RAPORTIN FINACIARË PËR GJASHTË MUJORIN E N.P.L PASTRIMI SH.A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- ky gjashtë mujorë ka qenë i jashtëzakonshëm dhe mbledhjet e KKSB-së mbahen çdo të premte të fundit të muajit . Për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme në këtë vit i kemi mbajtur katër mbledhje. Është lista e çështjeve të cilat janë trajtuar . Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Nora Xhoni thekson:- disa fëmijë po dalin dhe po shesin ujë të kufiri dhe është mirë që policia me vepruar për shkak se është rrezik prej pandemisë për shkak se dikush nga blerësit mund të jetë i infektuar dhe bartet te ata fëmijë.

Mehmet Ballazhi thekson:- në informatë shënon që është trajtuar edhe çështja e rrjetit elektrik dhe konkretisht çka është diskutuar për shkak se edhe në lagjen tonë kemi probleme me rrjetin .

Mallzum Qajani thekson:- qendra për punë sociale është marr me çështjen e fëmijëve të kufiri dhe nga një herë janë izoluar . Është biseduar me prindërit por me keqardhje e them por edhe qendra për punë sociale ka problem me bashkëpunuar me ta dhe ma thjeshtë ka mbetur me ndëshkuar prindin por edhe nuk ke se çka ndëshkon. Në KKSB diskutohen problemet që kanë të bëjnë me rrjetin elektrik por edhe gjatë sezonës së dimrit. Në fillim të viti KEDS-i ka premtuar bukur shumë dhe kanë premtuar edhe për trafon e fshatit Pustenik dhe ne si komunë kemi shpreh gatishmëri me participuar . Problemi është edhe i tensionit të lartë në fshatin Krivenik dhe në fillim të vitit kanë premtuar që kanë me rregulluar por konkrete diçka nuk ka . për problemin në lagjen e juaj ne i drejtohem me shkrim KEDS-it për me rregulluar rrjetin.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA NJOFTIMI I AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR GJASHTË MUJORIN E VITIT 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.


Mehmet Ballazhi thekson:- si kryesues i kuvendit të komunës çështjen e deklaratës e ke shtjelluar para se me filluar mbledhje dhe mirë do të ishte që me përcjellë edhe te anëtarët tjerë të kuvendit të komunës. Kjo deklaratë nuk ka të bëjë drejtë për drejtë me politik dhe është mirë ta diskutoni dhe në kuvend e bisedojmë.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:04

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc Qamush Brava

